

LIGJ Nr.10 293, datë 1.7.2010
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 017, DATË 13.11.2008
"PËR PËRCAKTIMIN E POLIGONEVE TË ASGJËSIMIT TË MUNICIONEVE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 017, datë 13.11.2008 "Për përcaktimin e poligoneve të asgjësimit të municioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4 pika 1, pas shkronjës "ë" shtohen shkronjat "f", "g", "gj" dhe "h" me këtë përmbajtje:

- "f) poligoni Kepi i Skënderbeut, Mat;
- g) poligoni Zharrë, Tepelenë;
- gj) poligoni Mali i Tërpanit, Berat;
- h) poligoni Qafa e Barit, Labinot Mal."

Neni 2

Pas nenit 4 shtohet neni 4/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1 Poligonet për asgjësimin e barutit

1. Poligonet për asgjësimin e barutit të Forcave të Armatosura janë:

- a) poligoni Xibrakë, Elbasan;
- b) poligoni Lumi i Oltës, Gramsh.

2. Koordinatat e poligoneve të asgjësimit të barutit të Forcave të Armatosura janë të përcaktuara në genplanet, që i bashkëlidhen këtij ligji."

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10

- 1. Ndalohet realizimi i asgjësimit të municioneve në det dhe jashtë kufirit shtetëror.
- 2. Distancat e sigurisë nga instalimet e shpimit dhe të shfrytëzimit të naftës, qendrat e banuara, rezervuarët, digat dhe vendet me rezerva të burimeve nënujore, monumentet e natyrës, zonat e mbrojtura, monumentet e kulturës të kategorisë I e II e zonat e tyre të mbrojtura dhe korridoret e hyrjes e të daljes së aviacionit civil në hapësirën ajrore të vendit do të jenë sipas përcaktimeve të bëra nga Ministria e Mbrojtjes, në përputhje me standardet e asgjësimit të municioneve.
- 3. Për përcaktimin e këtyre distancave merret mendimi i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, ndërsa për distancat e sigurisë nga digat e rezervuarëve të bujqësisë merret mendimi i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha."

Neni 4

Genplaneve të përmendura në nenin 4, bashkëlidhur ligjit, i shtohen genplanet që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6643, datë 15.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi